



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmanna • Ombudsperson Institution

GJYKATËS THEMELORE TË PRISHTINËS DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

2019 SEP 26 PM 3:33
NR. SHKR. BIL.SPISA
1
GJYKATËS THEMELORE
DEPART. I PËRGJITHSHËM
PRISHTINE PRISTINA

PADI

Me kërkesë për masë të përkohshme

PADITËSI:

Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës
Rruga: "Migjeni" nr. 21
10000 Prishtinë

I PADITURI:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Kosovës
Rruga: "Migjeni" nr. 21
10000 Prishtinë

Prishtinë, 26 shtator 2019

I. OBJEKTI:

Listat e kandidatëve të subjekteve politike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019 dhe të certifikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).

II. BAZA LIGJORE

Bazuar në Ligjin 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 1, paragrafi 2:

"Avokati i Popullit është mekanizëm i barazisë për promovim, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë pa diskriminim në bazat e mbrojtura nga Ligji për barazi gjinore dhe Ligji për mbrojtje nga diskriminimi."

Ndërkaq sipas nenit 16, paragrafi 7, të po këtij ligji:

"Kur Avokati i Popullit fillon procedurë me iniciativë të vetë lidhur me shkeljen e të drejtave dhe lirive të një numri më të madh të qytetarëve, të fëmijëve apo personave me aftësi të humbura veprimi, nuk është i nevojshëm pëlqimi nga paragrafi 6 i këtij neni."

Po ashtu, Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 2, paragrafi 2, Avokati i Popullit ka këto kompetenca:

2.3. Avokati i Popullit ka autorizim të hetoj ose të veproj mbi ndonjë ankesë të parashtruar ose me vetë-iniciativë (ex-officio) kur ka bazë për të dyshuar se ka ndodhur diskriminimi nga subjektet e sektorit publik.

Ndërkaq, neni 18 [Rastet e diskriminimit të cilat prekin grupet e personave], paragrafët 1 dhe 2, thotë:

"Rastet e diskriminimit të cilat prekin grupet e personave 1. Rastet e diskriminimit të cilat prekin grupet e personave mund të inicohen nëpërmjet një veprimi grupor të ndërmarrë në emër të tyre nga një organizatë joqeveritare ose nga Avokati i Popullit, në raste të tilla, nuk kërkohet pëlqimi i anëtarëve të grupit."

2. Këto veprime ligjore dorëzohen në gjykatën kompetente, me pretendimet në vijim:

2.1. të vendos se sjellja e tillë ka shkelur të drejtën për trajtim të barabartë në raport me pjesëtarët e grupit;

2.2. të ndalojë ndërmarrjen e veprimtarive të cilat shkelin apo mund të shkelin të drejtën për trajtim të barabartë, apo të kryejnë veprimtari të cilat eliminojnë diskriminimin apo pasojat e tij në lidhje me anëtarët e grupit;

2.3. të publikojë në media vendimin i cili vërteton shkeljen e së drejtës për trajtim të barabartë me shpenzimet e të paditurit.

Më tej, neni 14 [Procedura para gjykatës], paragrafët 1 dhe 3:

"1. Padia i paraqitet gjykatës kompetente sipas legjislacionit në fuqi nga personi ose grup i personave që ankohen se janë diskriminuar mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.

3. Subjektet kanë mundësi të paraqesin padi për diskriminim sipas këtij ligji, jo më vonë se pesë (5) vjet nga dita që i dëmtuari merr dijeni për këtë shkelje."

Neni 16 [Veprimet në procedurën kontestimore], paragrafi 1:

“Çdo person që pretendon që është viktimë e diskriminimit, sipas dispozitave të nenit një (1) të këtij Ligji, ka të drejtë të parashtojë padi kundër të paditurit dhe t’i ndërmarrë të gjitha veprimet juridike në gjykatën kompetente.”

Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore

Neni 13 [Avokati i Popullit]:

“Avokati i Popullit është institucion i barazisë që trajton rastet që lidhen me diskriminimin gjinor, në përputhje me procedurat e parapara me Ligjin për Avokatin e Popullit.”

Avokati i Popullit vazhdimisht e ka ngritur çështjen e mospërfaqësimit të barabartë në listat e kandidatëve të cilët garojnë në zgjedhje, për shkak se këto lista janë në kundërshtim me Ligjin nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore (në tekstin e mëtejshëm: LBGj) dhe me Ligjin nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi (në tekstin e mëtejshëm: LMD) dhe që këto ligje kërkojnë trajtim të barabartë në të gjitha sferat, duke përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në çështjet publike, përfshirë të drejtën për të zgjedhë dhe të drejtën për të qenë i zgjedhur, ligje të cilat nuk janë zbatuar edhe në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019, si nga subjektet politike të cilat i kanë propozuar listat e kandidatëve, e as nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejshëm: KQZ), gjatë certifikimit të partive politike.

III. LEJUESHMËRIA E PADISË

Avokati i Popullit e ka parasysh faktin se gjykata në procedurën kontestimore bazohet dhe udhëhiqet nga Ligji 03/L-006 për Procedurën Kontestimore i vitit 2008 dhe nga Ligji nr. 04/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore i vitit 2012. Megjithatë, në vitin 2015 ka hyrë në fuqi LMD-ja, i cili i jep gjykatë kompetenca për t’i trajtuar rastet e diskriminimit.

Neni 16 i LMD-së [Veprimet në procedurën kontestimore], paragrafët 1 dhe 2, nënparagrafi 3, përcakton:

“1. Çdo person që pretendon që është viktimë e diskriminimit, sipas dispozitave të nenit një (1) të këtij Ligji, ka të drejtë të parashtojë padi kundër të paditurit dhe t’i ndërmarrë të gjitha veprimet juridike në gjykatën kompetente.”

“2. Gjykata pasi që merr provat dhe argumentet relevante vërteton se i padituri ka kryer veprime apo mosveprimeve diskriminuese ndaj paditësit mund të vendos që:

2.3. të urdhërojë masa të përkohshme konform dispozitave të ligjit përkatës mbi procedurën kontestimore (nëse paditësi e ka bërë të bevueshme që e drejta e tij/saj për trajtim të barabartë është shkelur, dhe nëse është e nevojshme të urdhërojë një masë me synimin për të eliminuar rrezikun e dëmeve të riparueshme, veçanërisht për shkeljet e rëndta të të drejtës për trajtim të barabartë, apo me qëllim të parandalimit të dhunës). Prandaj, Avokati i Popullit, si institucion i barazisë sipas LBGj-së dhe si institucion me kompetenca të përcaktuara edhe me LMD, ia paraqet kësaj gjykate padinë për diskriminimin e grave në të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, si dhe kërkon nga kjo gjykatë trajtimin e kësaj padie.

IV. FAKTET E RASTIT

Me Vendimin nr. 236/2019, Presidenti i Republikës së Kosovës e ka caktuar datën e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, i cili, më 27 gusht 2019, është pranuar nga KQZ-ja.

Më 6 shtator 2019, ka qenë afati i fundit që subjektet politike t'i dorëzojnë në KQZ listat me emrat e kandidatëve të tyre për deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Më 10 shtator 2019, KQZ-ja, me vendime individuale për secilën parti politike, e ka miratuar rekomandimin e Zyrës për certifikimin e partive politike.¹

Nga të gjitha subjektet politike janë propozuar 1067 kandidatë. Nga lista e kandidatëve të subjekteve politike vërehet se 337 kandidatë janë të gjinisë femërore, ndërsa 730 janë të gjinisë mashkullore².

Koalicioni VAKAT/DEMOKRATSKA STRANKA BOŠNJAKA-DEMOKRATSKA STRANKA VATAN-UJEDINJENA STRANKA BOŠNJAKA në zgjedhje ka aplikuar të garojë me 55 kandidatë, prej të cilëve të gjinisë femërore janë 17, ndërsa të gjinisë mashkullore janë 38.

Koalicioni AAK-PSD në zgjedhje ka aplikuar të garojë me 110 kandidatë, nga të cilët të gjinisë femërore janë 34, ndërsa të gjinisë mashkullore janë 76.

Koalicioni NISMA-AKR-PD/NISMA SOCIAL/DEMOKRATË-ALEANCA KOSOVA E REPARTIA E DREJTËSISË në zgjedhje ka aplikuar të garojë me 110 kandidatë, nga të cilët të gjinisë femërore janë 53, ndërsa të gjinisë mashkullore janë 77.

Koalicioni SLOBODA në zgjedhje ka aplikuar të garojë me 8 kandidatë, nga të cilët të gjinisë femërore janë 3, ndërsa të gjinisë mashkullore janë 5.

PARTIA ROMË E BASHKUAR E KOSOVËS në zgjedhje ka aplikuar të garojë me 27 kandidatë, prej të cilëve të gjinisë femërore janë 7, ndërsa të gjinisë mashkullore janë 20.

GRADANSKA INICIATIVA GORA në zgjedhje ka aplikuar të garojë me 6 kandidatë, nga të cilët të gjinisë femërore janë 3, ndërsa të gjinisë mashkullore janë 3.

JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA në zgjedhje ka aplikuar të garojë me 13 kandidatë, nga të cilët të gjinisë femërore janë 4, ndërsa të gjinisë mashkullore janë 9.

SRPSKA LISTA në zgjedhje ka aplikuar të garojë me 17 kandidatë, nga të cilët të gjinisë femërore janë 6, ndërsa të gjinisë mashkullore janë 11.

INCIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS në zgjedhje ka aplikuar të garojë me 24 kandidatë, nga të cilët të gjinisë femërore janë 8, ndërsa të gjinisë mashkullore janë 16.

SAMOSTALNA LIBERALNA STRANKA në zgjedhje ka aplikuar të garojë me 13 kandidatë, nga të cilët të gjinisë femërore janë 4, ndërsa të gjinisë mashkullore janë 9.

NOVA DEMOKRATSKA STRANKA në zgjedhje ka aplikuar të garojë me 59 kandidatë, nga të cilët të gjinisë femërore janë 25, ndërsa të gjinisë mashkullore janë 34.

POKRET ZA GORA në zgjedhje ka aplikuar të garojë me 6 kandidatë, nga të cilët të gjinisë femërore janë 2, ndërsa të gjinisë mashkullore janë 4.

¹ Vendimet e KQZ-së për certifikimin e partive politike, të datës 9 shtator 2019.

² Komisioni Qendror Zgjedhor - Lista e kandidatëve të subjekteve politike për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019.

STRANKA DEMOKRATSKE AKCIJE në zgjedhje ka aplikuar të garojë me 9 kandidatë, nga të cilët të gjinisë femërore janë 3, ndërsa të gjinisë mashkullore janë 6.

KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA në zgjedhje ka aplikuar të garojë me 8 kandidatë, nga të cilët të gjinisë femërore janë 3, ndërsa të gjinisë mashkullore janë 5.

PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS në zgjedhje ka aplikuar të garojë me 50 kandidatë, nga të cilët të gjinisë femërore janë 17, ndërsa të gjinisë mashkullore janë 33.

PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE në zgjedhje ka aplikuar të garojë me 48 kandidatë, nga të cilët të gjinisë femërore janë 15, ndërsa të gjinisë mashkullore janë 33.

PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM në zgjedhje ka aplikuar të garojë me 38 kandidatë, nga të cilët të gjinisë femërore janë 12, ndërsa të gjinisë mashkullore janë 26.

KOSOVA DEMOKRATIK TÛRK PARTISI në zgjedhje ka aplikuar të garojë me 30 kandidatë, nga të cilët të gjinisë femërore janë 8, ndërsa të gjinisë mashkullore janë 22.

PARTIA KOSOVSKIH SRBA në zgjedhje ka aplikuar të garojë me 12 kandidatë, nga të cilët të gjinisë femërore janë 4, ndërsa të gjinisë mashkullore janë 8.

LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS në zgjedhje ka aplikuar të garojë me 110 kandidatë, nga të cilët të gjinisë femërore janë 34, ndërsa të gjinisë mashkullore janë 76.

FJALA në zgjedhje ka aplikuar të garojë me 50 kandidatë, nga të cilët të gjinisë femërore janë 15, ndërsa të gjinisë mashkullore janë 35.

PARTIA EUROATLANTIKE E KOSOVËS në zgjedhje ka aplikuar të garojë me 43 kandidatë, nga të cilët të gjinisë femërore janë 15, ndërsa të gjinisë mashkullore janë 28.

LËVIZJA VETËVENDOSJE në zgjedhje ka aplikuar të garojë me 110 kandidatë, nga të cilët të gjinisë femërore janë 33, ndërsa të gjinisë mashkullore janë 77.

PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS në zgjedhje ka aplikuar të garojë me 110 kandidatë, nga të cilët të gjinisë femërore janë 32 ndërsa të gjinisë mashkullore janë 78.³

V. LEGJISLACIONI LIDHUR ME BARAZINË GJINORE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 24 [Barazia para Ligjit]:

1. *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.”*

2. *“Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare o shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, afijësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.”*

3. *“Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përpunimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.”*

Neni 71 [Kualifikimet dhe Barazia Gjinore]

2. *“Përbërja e Kuvendit të Kosovës do të respektoj parimet e barazisë gjinore të cilat janë të pranueshme në pajtim me parimet ndërkombëtare.”*

³ Listat me kandidatët e propozuar të subjekteve politike, të dorëzuara në KQZ, për zgjedhjet e parakoisëme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019.

Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore (LBGj), në nenin 1, paragrafët 1 dhe 3, thekson:

"1. Ky ligj, garanton, mbroren dhe promovon barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë."

"3. Ky ligj është në përputhshmëri me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Femrës (CEDAW)."

Po aty, neni 2, paragrafi 1, përcakton:

"Ky ligj vlen për meshkujt, femrat dhe personat që kanë një karakteristikë të mbrojtur të identitetit gjinor apo të seksit, si dhe garanton mundësi dhe trajtim të barabartë, në sferën publike dhe private të jetës shoqërore, duke përfshirë jetën politike dhe publike, punësimin, arsimin, shëndetësinë, ekonominë, përfitimet shoqërore, sportin, kulturën dhe sferat tjera të përcaktuara me këtë ose ndonjë ligj tjetër."

Neni 4, paragrafi 1, përcakton çartë:

"Ndalohej diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë gjinor, duke përfshirë trajtimin më pak të favorshëm të femrave për shkak të shtatzënisë dhe amësisë, gjendjes martesore, kombësisë, racës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, statusit social, besimit fetar dhe besimit, mashës, ose ndonjë bazë tjetër të përcaktuar me ligj apo marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare në fuqi."

Kurse neni 5 [Masat e përgjithshme për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë gjinore], paragrafi 1, përcakton:

"Me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit gjinor si dhe arritjes së barazisë gjinore, institucionet e Republikës së Kosovës të të gjitha niveleve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe institucionet e tjera publike janë përgjegjëse për të zbatuar masat legislative dhe masat tjera duke përfshirë: (shihni ju lutem paragrafët e këtij nenin nga 1 deri në 9)."

Paragrafi 2 i nenit 5 përcakton:

"Çdo dispozitë, e cila është në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë sipas këtij ligji shfuqizohet."

Neni 6 [Masat e veçanta], paragrafi 2, përcakton:

"Masat e veçanta mund të përfshijnë: 2.1. kuotën për të arritur përfaqësimin e barabartë të femrave dhe meshkujve."

Ndërsa paragrafi 8 i këtij neni përcakton:

"Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse."

Neni 14 [Partitë politike] përcakton:

"Partitë politike me aktet e tyre obligohen të zbatojnë masat për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të meshkujve dhe femrave në organet dhe trupat e partive, në pajtim me dispozitat e nenit 6 të këtij ligji."

Neni 22 [Mbrojtja juridike e të drejtës së trajtimit të barabartë të femrave dhe meshkujve], paragrafi 1, përcakton:

"Personat të cilët konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, mund të iniciojnë procedura dhe paraqesin prova para organit administrativ apo Gjykatës kompetente në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi."

Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi parashih si në vijim:

Neni 1:

"Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, emisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, mashës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë haze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trojtitimit të barabartë."

Neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.14, përcakton:

"Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me: pjesëmarrjen në çështjet publike, përfshirë të drejtën për të zgjedhë dhe të drejtën për të qenë i zgjedhur."

Neni 3, paragrafi 2, përcakton:

"Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftejoj ose çënoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës."

Neni 5 [Format e rënda të diskriminimit] përcakton:

"Sjellja diskriminuese e cila është motivuar nga më shumë se një bazë apo e cila është kryer më shumë se një herë, apo e cila ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore apo ka pasur pasojë veçanërisht të dëmshme për viktimën konsiderohet formë e rëndë e diskriminimit."

Neni 8 [Përgjegjësitë e institucioneve të Republikës së Kosovës] përcakton:

"Të gjitha institucionet duhet të veprojnë në përputhje me parimet e këtij Ligji, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe gjatë hartimit të politikave dhe legjislacionit."

VI. ANALIZA LIGJORE

Çështjen e barazisë gjinore e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me legjislacionin vendor dhe me instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës, Avokati i Popullit e ka trajtuar dhe e ka ngritur në nivelin e instancave më të larta, në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në sistemin gjyqësor të vendit, përmes Raportit me rekomandime në lidhje me tri parimet e përgjithshme për interpretimin e akteve normative dhe zbatimin e këtyre parimeve në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përkatësisht të respektimit të barazisë gjinore⁴.

Një nga shembujt e zbatimit të parimeve interpretuese të ligjit ka të bëjë me raportin ndërmjet Ligjit nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore dhe Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me kërkesat e tyre përkatëse për përfaqësim gjinor mes përfaqësuesve të zgjedhur.

⁴ Bashkëngjitur gjeni Raportin me rekomandime nr. 441/2018, datë 28 shtator 2018.

Lidhur me këtë çështje, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme përcakton: “Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30%) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30%) për qind janë femra; me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë” (po aty, neni 27, par. 1).

Ndërsa Ligji për Barazi Gjinore paraqet një kërkesë më të rreptë: “Organet legjislative (...) janë të obliguara të miratojnë dhe zhatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas këtij ligji.”; duke theksuar: “Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë për qind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse” (po aty, neni 6, par. 7 dhe 8; theks i shtuar).

Cilit ligj duhet t’i jepet përparësi në rregullimin e kësaj çështjeje, Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme apo Ligjit për Barazi Gjinore?

Në këtë rast, dy prej parimeve interpretuese janë relevante. Që të dyja i japin përparësi Ligjit për Barazi Gjinore.

Për sa i përket parimit *lex specialis*, në fillim mund të duket e paqartë se cili ligj duhet konsideruar i posaçëm dhe cili i përgjithshëm, mund të duket se secili ligj rregullon një fushë të ndryshme specifike, prandaj asnjëri nuk gëzon përparësi në raport me tjetrin.

Mirëpo, sipas logjikës së GjEDNj-së në rastin *Kudla kundër Polonisë* ([GC], Aplikimi nr. 30210/96, GjEDNj, 26 tetor 2000, § 1460 është Ligji për Barazi Gjinore ai që duhet konsideruar si ligj i posaçëm. Siç u pa më sipër, GjEDNj-ja konsideron se, në shumicën e rasteve, neni 6, par. 1, është *lex specialis* në raport me nenin 13, sepse: “Mbrotjtjet e ofruara prej nenit 6, par. 1, të cilat përfshijnë rangun e plotë të procedurës gjyqësore, janë më të rrepta sesa ato të nenit 13 dhe i gëlltisnin ato” (*Kudla*, § 146; theks i shtuar).

Sipas së njëjtës logjike, kërkesa më e rreptë e Ligjit për Barazi Gjinore, që përfaqësimi i secilës gjini të jetë 50%, mund të konsiderohet *lex specialis* në raport me kërkesën më të ulët të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili kërkon vetëm përfaqësim prej 30% të secilës gjini. Prandaj, sipas parimit *lex specialis*, kërkesa më e rreptë e Ligjit për Barazi Gjinore gëzon përparësi në raport me atë më pak të rreptë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Po ashtu, edhe parimi *lex posterior* është me relevancë në këtë rast. Ligji për Barazi Gjinore u miratua nga Kuvendi më 28 maj 2015, ndërsa Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme u miratua shumë më herët, më 5 qershor 2008. Në bazë të kësaj, mund të konsiderojmë se kërkesa e përcaktuar në Ligjin për Barazi Gjinore reflekton më saktë vullnetin e përfaqësuesve të popullit në lidhje me këtë çështje dhe, për këtë arsye, ai duhet të gëzojë përparësi në raport me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Çështjet lidhur me sundimin e ligjit

Sundimi i ligjit nuk ka të bëjë vetëm me të drejtat e njeriut, por edhe me demokracinë. Demokracia ka të bëjë me përfshirjen e njerëzve në procesin e vendimmarrjes në shoqëri. Sundimi i ligjit zë vend në një shtet, qytetarët e të cilit ndihen kolektivisht të përgjegjshëm për zbatimin e sundimit të ligjit duke e bërë atë pjesë integrale të kulturës së tyre ligjore, politike dhe shoqërore.

Kur flitet për sundimin e ligjit, Avokati i Popullit i referohet Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si dhe standardeve më të mira ndërkombëtare.⁵

Sipas Kushtetutës, rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit etj.

Disa nga parimet themelore të sundimit të ligjit janë ligjshmëria, siguria juridike dhe barazia para ligjit dhe mosdiskriminimi.

Ligjshmëria ka të bëjë, mes tjerash, me epërsinë e ligjit, pajtueshmërinë me ligjin, raportin mes ligjit ndërkombëtar dhe vendor dhe detyrimin për zbatimin e ligjit.

Sipas **epërsisë së ligjit**, veprimet e shtetit duhet të jenë në pajtim me ligjin dhe të autorizuar me ligj. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit vë në pah se, me gjithë faktin që i padituri ka qenë subjekt i autorizuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme për të ndërmarrë veprime, për certifikimin e listave të subjekteve politike ai nuk ka vepruar në pajtim me LBGj-në. Kjo për faktin se LBGj-ja përcakton se përfaqësimi në të gjitha organet legjislative, ekzekutive, gjyqësore dhe në institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë për qind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse. Madje, LBGj-ja në mënyrë të qartë përcakton se partitë politike, me aktet e tyre, obligohen t'i zbatojnë masat për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të meshkujve dhe të femrave në organet dhe trupat e partive, në pajtim me dispozitat e nenit 6 të këtij ligji.

Sipas **pajtueshmërisë me ligjin, veprimet e shtetit** duhet ta respektojnë ligjin si për nga aspekti procedural, ashtu edhe për nga aspekti material. Në këtë kuptim, Avokati i Popullit vë në pah masat e veçanta të përcaktuara me LBGj, në veçanti me neni 6, paragrafi 7, sipas të cilit organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore, në të gjitha nivelet, si dhe në institucionet e tjera publike, janë të obliguara të miratojnë dhe të zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë që është më pak e përfaqësuar, deri në arrijen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe të meshkujve, sipas këtij ligji. Mosmiratimi apo moszbatimi i këtyre masave ka rezultuar me papajtueshmëri nga aspekti material me LBGj-në. Mbetet që i padituri ta dëshmojë nëse i ka ndërmarrë masat e përcaktuara me LBGj për rritjen e pjesëmarrjes së gjinisë që është më pak e përfaqësuar. LBGj-ja, përveç masave të veçanta, ka përcaktuar edhe masat e përgjithshme me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit gjinor si dhe arrijtes së barazisë gjinore. Institucionet e Republikës së Kosovës të të gjitha niveleve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe të institucioneve të tjera publike janë përgjegjëse për t'i zbatuar masat legjislative dhe masat tjera të përcaktuara me këtë ligj. Madje LBGj-ja ka përcaktuar qartë se shfuqizohet çdo dispozitë e cila është në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë sipas këtij ligji.

Prandaj, Avokati i Popullit vlerëson se i padituri nuk ka vepruar në pajtueshmëri me ligjin, meqenëse është dashur të veprojnë në pajtim me dispozitat e LBGj-së, pa marrë parasysh se çfarë përcakton Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në kuptimin e përcaktimit të kuotave gjinore.

⁵ Rule of Law Checklist, Venice Commission, CDL-AD (2016)007, 18 March 2016.

Sipas raportit mes ligjit ndërkombëtar dhe vendor vlen rregulli *pacta sunt servanda* (marrëveshja duhet të respektohet), i cili duhet të aplikohet pa marrë parasysh qasjes kombëtare në raportin mes të drejtës vendore dhe të drejtës ndërkombëtare. Zbatimi i plotë në vend i së drejtës ndërkombëtare është, me çdo kusht, qenësor. Në rastet kur e drejta ndërkombëtare është pjesë e ligjit vendor, sikur që është rasti në Republikën e Kosovës, atëherë kjo e drejtë është e detyrueshme në kuptimin e epërsisë së ligjit. Të kujtojmë këtu se Republika e Kosovës vullnetarisht i ka përfshirë në Kushtetutën e saj tetë instrumente ndërkombëtare, në mesin e të cilave edhe Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW). Madje edhe vetë LBGj-ja është përpiluar në përputhshmëri me CEDAW. CEDAW në nenin 3 përcakton se shtetet palë do t'i marrin të gjitha masat e përshtatshme në të gjitha fushat, sidomos në ato politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, duke përfshirë edhe legjisllacionin, për të siguruar zhvillimin e plotë dhe përparimin e grave me qëllim që t'u garantojnë atyre ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut mbi bazën e barazisë me burrat.

Veprimet e të paditurit, sipas vlerësimit të Avokatit të Popullit, janë në kundërshtim me dispozitat e CEDAW, ndërsa Kushtetuta përcakton se instrumentet ndërkombëtare me këtë Kushtetutë zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave, ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

Sipas detyrimit për zbatimin e ligjit organet shtetërore duhet që në mënyrë efektive ta zbatojnë ligjin. Thelbi i esencës së sundimit të ligjit do të vihet në pikëpyetje nëse ligji figuron vetëm në letër, por nuk zbatohet dhe nuk përmbushet në mënyrë të duhur. Vështirësitë në zbatimin efektiv të ligjit mund të ndodhin jo vetëm për shkak të veprimeve të kundërligjshme dhe neglizhencës së autoriteteve, por edhe për shkak të kualitetit të ligjeve. Sidoqoftë, në rastin konkret Avokati i Popullit pretendon se më parë bëhet fjalë për veprimet neglizhuese apo të kundërligjshme të autoriteteve sesa për kualitet të ligjit, konkretisht të LBGj-së, i cili siguron kuadrin institucional të nevojshëm për zbatim.

Siguria juridike ka të bëjë, mes tjerash, me pritjet legjitime

Pritjet legjitime shprehin idenë që autoritetet publike jo vetëm që duhet t'i përmbahen ligjit, por edhe premtimeve të tyre dhe pritjeve të krijuara nga këto premtime. Sipas doktrínës së pritjeve legjitime, ata që veprojnë me mirëbesim mbi bazën e ligjit, ashtu siç është e përcaktuar me ligj, nuk duhet të shqetësohen për sa u përket pritjeve të tyre legjitime. Kjo doktrinë nuk vlen vetëm për legjisllacionin, por edhe për vendimet individuale të autoriteteve publike. Ligji për Barazi Gjinore ka krijuar pritjet legjitime për faktin se më të kërkohet që përfaqësimi në të gjitha nivelet të jetë 50% për secilën gjini, ndërsa shumica e listave të kandidatëve për zgjedhjet nuk kanë më shumë se 30% gra, por kanë 70% burra.

Barazia para ligjit dhe mosdiskriminimi

Parimi i **mosdiskriminimit** kërkon ndalimin e çfarëdo trajtimi të pabarabartë me ligj, të paarsyctuar dhe se të gjithë personat e kanë të garantuar mbrojtjen e barabartë dhe efektive nga diskriminimi mbi bazat, si: raca, ngjyra, seksi, gjuha, religjioni, opinionet politike dhe të tjera, origjina kombëtare apo shoqërore, përkatësia me ndonjë minoritet etnik, prona, lindja apo ndonjë tjetër status.

Barazia në ligj (Equality in law)

Ligji duhet të sigurojë se ndalimi i diskriminimit nuk pengon mbajtjen apo miratimin e masave të veçanta të përkohshme të dizajnuara për të parandaluar ose për të kompensuar dëmet që personat pësojnë mbi bazën e përkatësisë së ndonjë grupi të caktuar ose për të ndihmuar pjesëmarrjen e tyre të plotë në të gjitha fushat e jetës. Këto masa nuk duhet të vazhdojnë pasi që të jenë arritur objektivat e synuara. Avokati i Popullit vlerëson se objektivat e përcaktuara me LBGj kanë mbetur të kufizuara, duke pas parasysh kuotën prej 30% e përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, ku nuk ka pasur asnjë lëvizje në drejtim të arritjes së barazisë.

Barazia para ligjit (Equality before the law)

Sundimi i ligjit kërkon nënshtrimin universal të të gjithëve ndaj ligjit. Sundimi i ligjit imponon që ligji të zbatohet në mënyrë të barabartë dhe të përmbushet në mënyrë konsistente. Megjithatë, barazia nuk është thjesht një kriter formal, por duhet të rezultojë në trajtimin e barabartë qenësor. Si përfundim, dallimet do të tolerohen, madje do të mund të kërkohen. Për shembull, veprimet afirmative mund të jetë mënyra për të siguruar barazinë qenësore në barazinë para ligjit në rrethana të kufizuara për të korrigjuar dëmet apo përjashtimet e së kaluarës.

Avokati i Popullit pretendon se, me gjithë faktin që LBGj-ja siguron kuadrin institucional të nevojshëm për zbatim të tij ligji, mbetet i pazbatuar, sepse të gjitha subjektet politike i kanë dërguar listat e kandidatëve në kundërshtim me Ligjin për Barazi Gjinore dhe KQZ-ja i ka certifikuar të gjitha listat e kandidatëve të subjekteve politike, pavarësisht faktit se asnjëra nga to nuk *ka përfaqësim minimal prej pesëdhjetë për qind (50%) për secilën gjini*.

Prandaj, Avokati i Popullit pretendon se KQZ-ja ka kryer diskriminim duke shkelur depozitat e lartcekura të LBGj-së dhe të LMD-së, me certifikimin e listave të kandidatëve ku *nuk sigurohet përfaqësi minimal prej pesëdhjetë për qind (50%) për secilën gjini*. Madje, Avokati i Popullit pretendon se veprimet e KQZ-së përbëjnë formë të rëndë të diskriminimit (sëhë nenin 5 të LMD-së), ngase sjellja diskriminuese është kryer më shumë se një herë (duke pasur parasysh faktin se LBGj-ja dhe LMD-ja kanë hyrë në fuqi në korrik të vitit 2015) në zgjedhjet lokale të vitit 2017 dhe me certifikimin e listave të kandidatëve për zgjedhjet e përgjithshme të parakohshme të 6 tetorit 2019, si dhe për faktin se kjo sjellje, duke qenë se zgjatë për një periudhë të gjatë kohore, shkakton pasoja për viktimat e kësaj shkeljeje, që rezulton me nënpërfaqësimin e tyre në jetën politike.

Avokati i Popullit konsideron se trajtimi i pabarabartë i gjinive në kundërshtim me Kushtetutën, me LBGj-në dhe me LMD-në do ta bëjë në mëdyshje kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e procesit zgjedhor, nga i cili pritet konstituimi i Kuvendit dhe formimi i Qeverisë, të cilat që nga themelimi do të mund të jenë në kundërshtim me Kushtetutën dhe me ligjet në fuqi.

VII. BARRA E PROVËS

Në procedurat para organeve administrative ose gjyqësore, sipas LMD-së, barra e provës përcaktohet me nenin 20, i cili përcakton:

"1. Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin prova para organit administrativ apo gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

2. Barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë."

Së këndejmi, Avokatit të Popullit, si paditës, nuk i kërkohet të ofrojë prova për shkeljet e pretenduara, edhe pse nga listat e kandidatëve (të bashkëngjitura këtu), në kuptimin e LMD-së dhe të LBGj-së, ka trajtim të pabarabartë *prima facie*.

VIII. PËRFUNDIM

Avokati i Popullit juaj rikujton se veprimet e institucioneve shtetërore duhet të jetë në përputhje dhe të autorizuara me ligj, prandaj konsideron se KQZ-ja edhe subjektet politike janë të obliguara për të siguruar respektimin e sundimit të ligjit dhe të veprojnë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kushtetuta e garanton barazinë para ligjit, në të gjitha aspektet, duke përfshirë këtu edhe të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes.

Neni 24 garanton barazinë para ligjit, ku paragrafi 2 i tij përcakton qartë: "Askush nuk mund të diskriminohet në bazë [...] gjinisë, [...] ose ndonjë statusi tjetër personal." Paragrafi 3 i po këtij neni përcakton: "Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato."

Avokati i Popullit konsideron se KQZ-ja nuk e ka zbatuar LBGj-në dhe gjithashtu nuk ka vënë ndonjë masë të nevojshme mbrojtëse që në lista zgjedhore të jetë përfaqësimi prej pesëdhjetë për qind (50%) për secilën gjini për zgjedhjet e përgjithshme të parakohshme, me gjithë faktin se LBGj-ja i obligon të gjitha institucionet që t'i ndërmarrin masat e veçanta.


Së këndejmi, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 18, paragrafi 2, nënparagrafët 2.1, 2.2 dhe 2.3, të Ligjit nr. 05/l-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, i propozon Gjykatës Themelore të Prishtinës, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, të nxjerrë:

AKTGJYKIM

Me të cilin aprovetohet padia e Avokatit të Popullit kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si e bazuar dhe të vendosë se:

1. Sjellja e KQZ-së ka shkelur të drejtën për trajtim të barabartë të grave në të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes.
2. Të ndalojë ndërmarrjen e veprimtarive të cilat shkelin apo mund të shkelin të drejtën për trajtim të barabartë, apo të kryejnë veprimtari të cilat eliminojnë diskriminimin apo pasojat e tij në lidhje me trajtimin e pabarabartë të grave në të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes.
3. Ta publikojë në media vendimin i cili vërteton shkeljen e së drejtës për trajtim të barabartë.

Paditësi


Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

KËRKESË PËR MASË TË PËRKOSSHME

Në bazë të argumenteve të lartcekura, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, me anë të kësaj parashtrese, kërkon që kjo gjykatë, në pajtim nenin 16 [Veprimet në procedurën kontestimore], paragrafi 2, nënparagrafi 3, të LMD-së, të urdhërojë masa të përkohshme. Sidoqoftë, LMD-ja kërkon që masa e përkohshme të vendoset në pajtim me Ligjin për Procedurën Kontestimore, i cili nuk parashih vendosjen e masës së sigurisë lidhur me paditë në rastet e diskriminimit. Megjithatë, LMD-ja parashih që gjykata do të urdhërojë masë të përkohshme në rastet kur e drejta për trajtim të barabartë është shkelur dhe, nëse është e nevojshme, të urdhërojë një masë me synimin për të eliminuar rrezikun e dëmeve të pariparueshme, veçanërisht për shkeljet e rënda të së drejtës për trajtim të barabartë.

Rikujtojmë këtu se LMD-ja ka hyrë në fuqi në vitin 2015, ndërsa Ligji për Procedurën Kontestimore ka hyrë në fuqi në vitin 2008, dhe në rastin konkret gjykata do të duhej të vepronte në bazë të parimit *lex posterior derogat lex prior*, i cili udhëzon se akti normativ i mëvonshëm duhet të gëzojë përparësi në raport me atë të mëhershmin.

Avokati i Popullit konsideron se trajtimi i pabarabartë i gjinive në kundërshtim me Kushtetutën, me LBGj-në dhe me LMD-në do ta bie në mëdyshje kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e procesit zgjedhor, nga i cili pritet konstituimi i Kuvendit dhe formimi i Qeverisë, të cilat që nga themelimi do të mund të jenë në kundërshtim me Kushtetutën dhe me ligjet në fuqi.

Së këndejmi, Avokati i Popullit kërkon nga gjykata aprovimin e masës së përkohshme në procesin zgjedhor, duke kërkuar nga i padituri rishikimin e listave të partive politike, të jenë në pajtim me dispozitat në vijim:

LBGj, neni 6 [Masat e veçanta], paragrafi 8:

"Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse."

Neni 14 [Partitë politike]:

"Partitë politike me aktet e tyre obligohen të zbatojnë masat për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të meshkujve dhe femrave në organet dhe trupat e partive, në pajtim me dispozitat e nenit 6 të këtij ligji."

Paditësi

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit